**VENDIM**
**Nr.638, datë 18.9.2003**

# PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 dhe 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Caktimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1 përcaktohet sipas lidhjes nr.2 të këtij vendimi.

- " Paga e grupit 1" u jepet punonjësve me diplomën e shkollës së lartë të infermierisë.
- "Paga e grupit 2" u jepet punonjësve me:

a) diplomë të shkollës së mesme mjekësore;

b) diplomën e shkollës së mesme dhe dëshminë e kualifikimit të kurseve 1 dhe 2- vjeçare, për degën infermier/mami, ndihmësinfermier/mami.

- "Paga e grupit 3" u jepet punonjësve me arsim tetëvjeçar.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

6. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 5 të lidhjes nr.1.

7. Punonjësit e infermieristikës, që punojnë larg vendbanimit, marrin shpërblim mujor, si më poshtë vijon:

a) Kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 1000 lekë në muaj.

b) Kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 3000 lekë në muaj.

8. Për punën e kryer nga ora $19^{00}$ deri në $22^{00}$ përfitojnë shtesë mbi pagë 50 lekë për çdo ditë.

Për punën e kryer në intervalin $22^{00}$ dhe $6^{00}$ përfitojnë shtesë mbi pagë 250 lekë për çdo ditë.

9. Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës u jepet një shtesë si më poshtë vijon:

| | Në ditë të zakonshme | të shtuna | të diela dhe festa |
|---|---|---|---|
| - për sistemin 24 orë | 1050 lekë | 1300 lekë | 1600 lekë; |
| - për sistemin 16 orë | 850 lekë | 1050 lekë | 1400 lekë; |
| - për sistemin 12 orë | 650 lekë | 850 lekë | 1050 lekë. |

10. Për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të Ministrisë së Shëndetësisë, laborantët e spitaleve kryejnë shërbim 24 orë u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

| | |
|---|---|
| - për ditë të zakonshme | 1300 lekë; |
| - për ditët e shtuna | 1600 lekë; |
| - për ditët e diela dhe festa | 2100 lekë. |

11. Për raste të veçanta, kur mjeku i rojës e sheh të domosdoshme thirrjen e personelit të infermieristikës për kryerjen e ekzaminimit apo të mjekimit, ky personel shpërblehet në masën 300 lekë deri në lekë 750 lekë, për çdo rast.

Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20% e pagës mujore për çdo muaj.

12. Ministri i Shëndetësisë përcakton kriteret dhe rregullat për dhënien e shpërblimit sipas pikave 9, 10 dhe 11 të këtij vendimi.

13. Ky vendim nuk zbatohet për punonjësit e Institutit të Shëndetit Publik, Tiranë.

14. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2003 të përballohen nga buxheti i vitit 2003, i parashikuar për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 shtator 2003.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

LIDHJA 1
(Kreu 1.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMJERISTIKËS NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSETRIK GJINEKOLOGJIK TIRANË , SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE "SHEFQET NDROQI" TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Kryeinfermier/kryemami i përgjithshëm spitali<br>Kryeinfermier shërbimi psikiatrik | | 2% | 0 | 9300 | 3500 | Nga..deri …lekë |
| Kryelaborantë në shërbimin e anatomisë patologjike<br>Kryeinfermier shërbimi terapisë intensive<br>Kryeinfermiere shërbimi onkologjik<br>Kryelaborant rrezatim kobalti<br>Kryelaborant në histopatologji<br>Kryeinfermiere reparti i rrezatimit | | 2% | 0 | 9300 | 3200 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermiere shërbimi neurokirurgji<br>Kryeinfermiere reparti në psikiatri<br>Kryeinfermier/kryemami reparti i terapisë intensive | | 2% | 0 | 9300 | 2500 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermiere kimioterapi<br>Kryelaborant klinik biokimik<br>Kryinfermiere në urgjencën e sëmundjeve të brendshme<br>Infermiere në hemodinamikë | | 2% | 0 | 9300 | 1700 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermiere shërbimi (kirurgji, neurologji, djegie plastike, kardiokirurgji, maksilofacial)<br>Kryeinfermier/kryemami në | | 2% | 0 | 9300 | 1000 | Nga..deri …lekë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| repartin e kirurgjisë<br>Kryeinfermiere reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neuologjisë, neurokirurgji, onkologji)<br>Kryeinfermiere/kryemami salle operacioni | | | | | | |
| Kryeinfermiere shërbimi<br>Kryelaborante shërbimi | | 2% | 0 | 9300 | | Nga..deri …lekë |
| Infermiere në psikiatri | | 2% | 0 | 8370 | 3500 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere në kyriterapi<br>Laborant histopatolog | | 2% | 0 | 8370 | 3200 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere/mami reanimacioni<br>Infermiere në dhomën e zgjimit | | 2% | 0 | 8370 | 2500 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere në kimioterapi | | 2% | 0 | 8370 | 1700 | Nga..deri …lekë |
| Kryelaborant radiologjie | | 2% | 0 | 8370 | 1400 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermiere e edukimit shëndetësor TB | | 2% | 0 | 8370 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermier në repartin e alergologjisë<br>Kryeinfermiere në sterilizim<br>Kryemami në izolim | | 2% | 0 | 8370 | | Nga..deri …lekë |
| Laborant radiolog në psikiatri dhe onkologji | | 2% | 0 | 7440 | 3500 | Nga..deri …Leke |
| Laborant rezatim kobalti | | 2% | 0 | 7440 | 3200 | Nga..deri …Leke |
| Laborant në mjekësinë bërthamore | | 2% | 0 | 7440 | 2500 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere në njësinë e inspektoratit sanitar dhe infeksioneve nozokomiale | | 2% | 0 | 7440 | 2000 | Nga..deri …Leke |
| Kryeinfermier reparti pranim urgjencë<br>Laborant klinik biokimik<br>Infermier në punktin e gjakut<br>Infermier në hematologji<br>Infermier në onkologji | | 2% | 0 | 7440 | 1700 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere reparti radilologjik<br>Kryeinfermiere (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji) | | 2% | 0 | 7440 | 1400 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere/mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike)<br>Instrumentare | | 2% | 0 | 7440 | 1000 | Nga..deri …lekë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Kryemami shërbimi obsetrik<br>Kryeinfermiere neonatologji<br>Kryemami në qendrën e gruas<br>Kryemami pranimi<br>Kryeinfermiere në kabinetin e dializës<br>Kryemami/kryeinfermiere reparti<br>Kryeinfermiere konsultash në sëmundjet e brendshme<br>Kryelaborant (bakterolog, imunolog, ortopedi stomatologjike)<br>Infermiere sterilizimi | | 2% | 0 | 7440 | | Nga..deri …lekë |
| Infermiere pavioni rrezatimi | | 2% | 0 | 6230 | 3200 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere (infektiv, pranim urgjencë, njësia e koordinimit të urgjencës)<br>Laborant (bakterolog, imunolog) | | 2% | 0 | 6230 | 1700 | Nga..deri …lek♪7 |
| Laborant radiolog<br>Ndihmës farmacist | | 2% | 0 | 6230 | 1400 | Nga..deri …lekë |
| Infermier fizioterapi | | 2% | 0 | 6230 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Laborant (ezhe, ortopedi stomatologjike)<br>Kryeinfermiere çerdheje për personelin<br>Infermier | | 2% | 0 | 6230 | | Nga..deri …lekë |
| Infermier çerdheje për personelin<br>Kujdestar në pediatri | | 2% | 0 | 5600 | | Nga..deri …lekë |
| Kujdestar në psikiatri | | 2% | 0 | 5600 | 2500 | Nga..deri …lekë |

LIDHJA 1
(Kreu 1.2)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORINË E SHËNDETIT PUBLIK NË RRETHE

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetersi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Kryeinfermier i përgjithshëm | | 2% | 0 | 8370 | | Nga..deri …lekë |
| Infermer statistike | | 2% | 0 | 6230 | | Nga..deri …lekë |

LIDHJA 1
(Kreu 1.3)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË DREJTORITË E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR DHE SHËRBIMET E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR, AUTORITETIN SHËNDETËSOR RAJONAL TË TIRANËS, ADMINISTRATËS SË NJËSISË SË TRANSPORTIT MJEKËSOR ME HELIKOPTER

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Kryeinfermier i përgjithshëm | | 2% | 0 | 8370 | | Nga..deri …lekë |
| Ndihmës inspektor sanitar,ndihmës higjenist, ndihmës epidemiolog | | 2% | 0 | 7440 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere në psikiatri, qendrën komunitare të shëndetit mendor | | 2% | 0 | 7440 | | Nga..deri …lekë |
| Infermiere (hematologji,onkologji)<br>Laborant rontgeni | | 2% | 0 | 6230 | 1400 | Nga..deri …lekë |
| Infermier ortopedi<br>Infermier/laborant në fizioterapi | | 2% | 0 | 6230 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermier/kryemami<br>Infermier në shërbimin stomatologjik<br>Laborant bakterolog/klinik biokimik<br>Ndihmës dentist | | 2% | 0 | 6230 | | Nga..deri …lekë |
| Ndihmës bakterolog<br>Infermier/mami | | 2% | 0 | 5860 | | Nga..deri …lekë |
| Ndihmës infermier | | 2% | 0 | 5600 | | Nga..deri …lekë |

LIDHJA 1
(Kreu 1.4)

**Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Spitalet e rretheve, Qendrën e Mirërritjes Zhvillimit dhe Reabilitimit të Fëmijëve Tiranë**

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Kryeinfermier i përgjithshëm | | 2% | 0 | 9300 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Laborant në anatominë patologjike | | 2% | 0 | 8370 | 3200 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermier në psikiatri | | 2% | 0 | 8370 | 2500 | Nga..deri …lekë |
| Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik<br>Kryeinfermier (kirurgji, reanimacion, sallë operacioni, obsetrikë gjinekologji) | | 2% | 0 | 8370 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermjer | | 2% | 0 | 8370 | | Nga..deri …lekë |
| Infermier në psikiatri | | 2% | 0 | 7440 | 2500 | Nga..deri …lekë |
| Infermiere reanimacion<br>Ndihmës anesteziste<br>Ndihmës farmaciste | | 2% | 0 | 6230 | 1400 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermiere në poliklinikën e spitalit<br>Infermier (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, qendrës së shëndetit mendor, infektiv, dispanceri të sëmundjeve ngjitëse, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji, pneumoftiziatri, onkologji,dispanceri)<br>Infermiere në repartin e lindjes<br>Instrumentare<br><br>Infermier/laborant në bankën e gjakut, hematologji. | | 2% | 0 | 6230 | 1000 | Nga..deri …lekë |
| Kryeinfermiere në qendrën e sterilizimit<br>Infermier pranim urgjence<br>Laborant klinik biokimik/bakteriologjik | | 2% | 0 | 6230 | 500 | Nga..deri …lekë |
| Infermier | | 2% | 0 | 6230 | | Nga..deri …lekë |
| Kujdestar në psikiatri | | 2% | 0 | 5600 | 2500 | Nga..deri …lekë |
| Kujdestar në pediatrik<br>Ndihmës infermier | | 2% | 0 | 5600 | | Nga..deri …lekë |

LIDHJA 1
(Kreu 1.5)

STRUKTURA E PAGAVE PËR LABORANTËT NË LABORATORIN E KONTROLLIT TË BARNAVE

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa per kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Laborant | | 2% | 0 | 8 000 | | Nga..deri …lekë |

LIDHJA 1
(Kreu 1.6)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERIMERISTIKËS NË KLINIKAT E SHËRBIMEVE MJEKËSORE

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa per Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Kryeinfermier | | 2% | 0 | 9300 | | Nga..deri …lekë |
| Infermier<br>Ndihmës stomatologe | | 2% | 0 | 6230 | | Nga..deri …lekë |

LIDHJA 1
(Keri 1.7)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERIMERISTIKËS NË QENDRËN KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË GJAKUT

| EMËRTIMI | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | Paga e groupie (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| Kryeinfermier<br>Kryelaborant | | 2% | 0 | 8370 | | Nga..deri …lekë |
| Infermier<br>Laborant | | 2% | 0 | 6230 | 1000 | Nga..deri …lekë |

LIDHJA NR. 2

| GRUPI | PAGA NË LEKË |
|---|---|
| 1 | 6930 |
| 2 | 6265 |
| 3 | 4160 |